



RAPORTI VJETOR 2021



Për herë të parë, në 10 kompanitë publike e private me xhiron vjetore më të lartë në Republikën e Shqipërisë!

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

www.dpshttr.gov.al

PËRMBAJTJA

1. CILËT JEMI NE?	4
2. ARRITJET DHE IMPAKTI YNË GJATË VITIT 2021	5
•Shërbimet dhe të ardhurat	
•Kontributi si agjent tatimor në buxhetin qendror dhe buxhetin e njësjive vendore. Kontributi fiskal.	
3. SHËRBIME RISI	15
•Kontrolli teknik	
•Ndërrimi i pronësisë në sportelet e DRSHTRR	
•Targa me përzgjedhje	
•Errësimi i xhamave të mjetit	
•Targa suvenir	
4. SHËRBIMI I KONTROLLIT TEKNIK TË MJETEVE	23
5. RITJJA E PERFORMANCËS NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE	26
ME FOKUS QYTETARIN	
•Vëmendja te qytetarët	
•Digjitalizimi i shërbimeve	
•Aplikime online përmes web	
•Shërbime në e-Albania	
6. INTEGRIMI EVROPIAN I LEJES SHQIPTARE TË DREJTIMIT	32
7. INVESTIME DHE INFRASTRUKTURA E SHËRBIMIT	34
•Investime në drejtoritë rajonale	
•Transparenca mbi administrimin e buxhetit të DPSHTRR për prokurime/investime gjatë vitit 2021	
•Investime në digjitalizim, informatizim dhe shërbime	
8. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN	54
•Komunikimi me publikun, trajtimi i ankesave	
•Open data	
9. e-TRANSPORT	59
E ardhmja digjitale e transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve	
10. TASK-FORCA E TRANSPORTIT RRUGOR	61
11. AUTOMOTO PARK ALBANIA	63

12. BURIMET NJERËZORE.....	64
•Vende të reja pune	
•Praktikat profesionale	
•Shëndeti i punonjësve: paketa sociale, COVID dhe masat në sportele	
13. PROJEKTE EDUKATIVE PËR SIGURINË RRUGORE.....	68
•Këndi edukativ i sigurisë rrugore	
•Këndi statik i sigurisë rrugore në shkollën industriale “Pavarësia”, Vlorë	
•Botime dhe broshura edukative	
•Promovimi online dhe emisione edukative	
14. KOLEKSIONI SHQIPTAR RETRO.....	72
•Shërbimi dhe komisioni RETRO	
•RETRO tour	
•Katalogu RETRO	
15. PËRGJEGJËSIA SOCIALE.....	75
•Solidariteti ndaj personave në nevojë	
•Dhuro gjak, shpëto jetë	
•Pasurimi i natyrës, pastrimi i territorit	
•Festojmë së bashku	
16. ANËTARËSIME & ÇMIME.....	77



Viti 2021 për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, shënoi rezultate të larta dhe historike falë mirëadministrimit, përmirësimit të ndjeshëm të shërbimit e sporteleve virtuale, komunikimit me qytetarët, sistemeve inovative të shërbimeve online dhe informatizimit, modernizimit të infrastrukturës e kushteve të punës dhe kontributit për parandalimin e korrupsionit në sektor. Këto ndryshime u reflektuan duke përmirësuar transparencën, përgjegjshmërinë, uljen e debitorëve, rritjen e sigurisë, digjitalizimin, monitorimin, rendimentin, transparencën, fiskalizimin dhe zgjerimin e rrjetit në territor. Kjo u realizua përmes shërbimeve risi e lehtësimeve të procedurave, falë besimit e mbështetjes nga qeveria, por mbi të gjitha falë një ekipi të angazhuar drejt një misioni të përbashkët.

Të motivuar e të përkushtuar për të përmirësuar kulturën automotive e për të sjellë një frymë ndryshimi në transportin rrugor dhe përqasjen e drejtimit të mjetit, së bashku me njohjen e rregullave të qarkullimit rrugor në Shqipëri, si DPSHTRR, ju ftojmë të ndiqni rrugëtimin tonë të përmbledhur në **“Raportin Vjetor 2021”**, si një pasqyrë transparente e të gjitha arritjeve tona drejt sfidave të reja të automotorizimit shqiptar.

1. CILËT JEMI NE?

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është një institucion me vetëfinancim dhe kapital tërësisht shtetëror, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 343, dt. 21.07.1999, në zbatim të Ligjit Nr. 8378, dt. 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ku në fokusin e saj të shërbimit dhe veprimtarisë përfshihen:

- Regjistrimi i mjeteve rrugore në Republikën e Shqipërisë me dokumentacionin e duhur;
- Organizimi, shtypja dhe shpërndarja e dokumentacionit bazë për transportin rrugor, si dhe prodhimi i targave të mjeteve sipas formateve të ndryshme;
- Kontrolli teknik i mjeteve rrugore për të garantuar standarde të larta sigurie për flotën e mjeteve rrugore në qarkullim;
- Testimi i njohurive teorike dhe praktike për drejtimin e mjetit dhe pajisjen e drejtuesve të rinj të mjeteve me lejen e drejtimit dhe për të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme për të udhëtuar me mjet;
- Pajisje me dëshmi, certifikata dhe licenca për subjekte të ndryshme të transportit rrugor si: transporti i udhëtarëve, transporti i mallrave, autoshkolla, etj.;
- Edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë rrugore nga drejtuesit e mjeteve, por edhe nga përdoruesit e tjerë të rrugës përmes programeve dhe projekteve edukative;

- Mjetet historike të Koleksionit Shqiptar RETRO. Jetëzimin e një trashëgimie deri dje pa status. Promovimi dhe ekspozimi i sa më shumë mjeteve si një kujtesë automotorizimi me interes historik, si dhe ofrimin e informacioneve, shërbimeve dhe lehtësirave për këtë aktivitet pasionant me ndjeshmëri kaq të veçantë.

DPSHTRR ofron rreth **2.7 milionë shërbime në vit** përmes 13 drejtorive rajonale dhe 17 nënzyrave të shërbimeve të transportit rrugor të shpërndara në të gjithë Shqipërinë, si dhe përmes shërbimeve online si një vizion i ri drejt modernizimit dhe revolucionit digjital të shërbimeve ndaj qytetarëve nën sloganin **“Më Lehtë, Më Shpejt, Më Lirë”!**


2. ARRITJET DHE IMPAKTI YNË GJATË VITIT 2021

Shërbimet dhe të ardhurat

Në fokusin kryesor të DPSHTRR-së është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve përmes lehtësimit të procedurave, afrimit të shërbimeve më pranë qytetarëve përmes shtrirjes territoriale, ofrimin të shërbimeve risi, si edhe aplikimeve dhe shërbimeve online përmes platformës e-Albania dhe faqes zyrtare www.dpshttr.gov.al.

Në vitin 2021, DPSHTRR ka realizuar 2,734,716 shërbime. Një shifër rekord shërbimesh krahasuar me vitet e kaluara:


Shërbime të ofruara sipas viteve




Shërbimet e ofruara sipas Drejtorive Rajonale

Numrin më të lartë të shërbimeve e kryeson DRSHTRR Tiranë me 34.4% të numrit total të shërbimeve, të pasuar nga DRSHTRR Durrës me 13.1% dhe DRSHTRR Fier me 9.2%.

Shërbime




Kontributi në % i shërbimeve



► Qytetarë të shërbyer në 1 orë sipas Drejtorive Rajonale

Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, në DRSHTRR Tiranë shërbehen mesatarisht 445 qytetarë në orë, pasuar nga DRSHTRR Durrës me 169 qytetarë në orë dhe DRSHTRR Fier me 118 qytetarë në orë. Ky fluks i lartë shërbimesh lidhet me numrin më të lartë të popullsisë, të drejtuesve të mjeteve dhe mjeteve të regjistruara në këto qytete. Ndaj për mirëadministrimin e radhëve, janë vendosur sisteme elektronike radhe, sisteme rezervimi online të shërbimit në sportel, si dhe janë hapur zyra rajonale shërbimi për të krijuar më shumë lehtësi në marrjen e shërbimit.

Qytetarë/subjekte të shërbyer në 1 orë sipas Drejtorive Rajonale



Të ardhurat për vitin 2021, sipas llojit të shërbimit

Numri i lartë i shërbimeve dhe veçanërisht ofrimi i shërbimeve risi në vitet e fundit, ka gjeneruar të ardhura mjaft të larta, duke mundur investime të mëtejshme në sisteme digjitale, infrastrukturë shërbimi, përmirësim të kushteve të punës e ofrimit të shërbimit, investim në kapacitete njerëzore e profesionale. Gjithashtu, duhet konsideruar se janë hequr e lehtësuar procedura, janë ulur tarifa të shërbimeve, janë zgjatur afatet e vlefshmërisë së dokumenteve të ndryshme ku kanë përfituar me qindra mijëra qytetarë.

Në vitin 2021, DPSHTRR ka realizuar

3,041,101,000 Lekë




të ardhura, një vlerë e rritur ndjeshëm në krahasim me vitet e tjera!

Infografikat pasqyrojnë pjesën takuese të DPSHTRR: % si agjent tatimor nga taksat e mjeteve, tarifa, të ardhura shërbimesh risi dhe pjesë nga gjoba që i takojnë entit.

Të ardhurat sipas viteve

Në vitin 2021:



1.36

IRR-NORMA
E BRENDSHME
E KTHIMIT!

1.36 LEKË TË ARDHURA
MË SHUMË PËR ÇDO
1 LEK TË SHPENZUAR

113%

**REALIZIM
I PLANIT!**


810,727,000 Lekë

fitimi i realizuar gjatë vitit 2021!

(Janë zbritur shpenzimet, pagat dhe detyrimet)



Fitimi i realizuar sipas viteve
(Lekë)



► **Llojet e shërbimeve të ofruara dhe të ardhurat në vitin 2021**

REGJISTRIM MJETI 888,768 SHËRBIME 1,312,968,000 LEKË

Krahasuar me vitin 2018: +55% shërbime më shumë
+62% të ardhura më shumë

Krahasuar me vitin 2019: +39% shërbime më shumë
+46% të ardhura më shumë

LEJE DREJTIMI 650,930 SHËRBIME 719,869,000 LEKË

Krahasuar me vitin 2018: +16% shërbime më shumë
+16% të ardhura më shumë

Krahasuar me vitin 2019: +4% shërbime më shumë
+10% të ardhura më shumë

TAKSA DHE TARIFA 816,804 SHËRBIME 488,529,000 LEKË

Krahasuar me vitin 2018: +22% shërbime më shumë
+58% të ardhura më shumë

Krahasuar me vitin 2019: +15% shërbime më shumë
+36% të ardhura më shumë

KONTROLLI TEKNIK 213,063 SHËRBIME 419,318,000 LEKË

SHËRBIME TË TJERA 185,467 SHËRBIME 100,417,000 LEKË

VITI 2021:**417,552,723 Lekë**

të ardhura si Agjent Tatimor (pa gjokat)

+ 124,934,723


Lekë të ardhura më shumë se në vitin 2018!

+ 102,075,723

Lekë të ardhura më shumë se në vitin 2019!

+ 4,424,723

Lekë të ardhura më shumë se në vitin 2020!

Të ardhura si Agjent Tatimor (pa gjokat)

Kontributi si agjent tatimor në buxhetin qendror dhe buxhetin e njësive vendore. Kontributi fiskal.

Falë mirëadministrimit, informatizimit e mirëorganizimit të punës gjatë vitit 2021, si një vit i vështirë post tërmet, në kushtet e pandemisë globale Covid-19, me masa e kufizime, u arritën rezultate REKORD të ekipit të DPSHTRR-së. Kjo vërehet në volum arkëtimi, në kontributin si agjent tatimor për Buxhetin Qendror e Vendor, në të ardhurat për vetë entin, si dhe në kontributin fiskal të entit në buxhetin e shtetit si tatimpagues!

VITI 2021:

5,076,710,638 Lekë

Kontributi në Buxhet Qendror (Vetëm nga TVMP) si Agjent Tatimor

+ 1,026,330,647

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2018!


+ 704,443,201

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2019!

+ 400,035,888

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2020!

Kontributi në Buxhet Qendror si Agjent Tatimor
(Vetëm TVMP: sipas viteve)



VITI 2021:**1,692,236,879 Lekë**

Kontributi në Buxhet Vendor (Vetëm nga TVMP) si Agjent Tatimor

+ 342,109,882

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2018!


+ 234,814,733

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2019!

+ 133,345,629

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2020!

Kontributi në Buxhet Vendor si Agjent Tatimor
(Vetëm TVMP: Periudha sipas viteve)



VITI 2021:

744,179,081 Lekë

Kontributi Fiskal në Buxhet si Ent Tatimpagues

+44,771,827

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2020!


+115,194,645

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2019!

+137,198,528

Lekë kontribut më shumë se në vitin 2018!

Kontributi fiskal si Operator ekonomik Tatimpagues (lekë)




3. SHËRBIME RISI



Kontrolli Teknik

Shërbimi i Kontrollit Teknik të mjeteve rrugore iu rikthye DPSHTRR-së në vitin 2021, duke rifilluar shërbimin zyrtarisht në datën 31 maj 2021.



Qershor – Dhjetor 2021

213,063 Numri i Shërbimeve të Kontrollit Teknik

419,318,000 Të ardhurat nga Kontrolli Teknik



Ndërrimi i Pronësisë në sportelet e DRSHTRR



Shërbimi i Ndërrimit të Pronësisë në sportelet e DRSHTRR-së i mundëson të gjithë qytetarëve dhe subjekteve që janë të interesuar për shit-blerjen e mjetit ose për ndërrimin e pronësisë së mjetit, që të realizojnë këtë procedurë në sportelet e juristëve në DRSHTRR si trajtë “One Stop Shop” duke kursyer kohë dhe kosto. Ky shërbim ka nisur të ofrohet prej datës 1 mars 2019 në të gjitha drejtoritë rajonale. Gjithashtu në vitin 2022 do të mundësohet heqja e kontrollit fizik kur kryhet shërbimi i ndërrimit të pronësisë.



**Ndërrime
Pronësie
të Mjetit**

**18,791,000
Lekë**

të ardhura



ABC - 123

Targa me Përzgjedhje

Në datën 8 prill 2019, ka nisur shërbimi i rezervimit ONLINE i Targave me Përzgjedhje. Është një nga shërbimet më të preferuara nga komuniteti i të pasionuarve pas mjeteve, ku qytetarët mund të përzgjedhin online targën sipas dëshirës me kombinime si: 777, 001, ose lloje të ndryshme kombinimesh të numrave dhe të gërmave. Ky shërbim para se të ofrohej online, ishte burim rryshfetesh pasi nuk ishin të vendosura në sistem për aksesim blerje nga çdo qytetar. Tashmë është kthyer në një shërbim të thjeshtë për t'u përdorur nga qytetarët, i shpejtë për rezervimin dhe porositjen dhe mbi të gjitha, ofron transparencë për publikun!

Për vitin 2021:

8,212

Targa me Përzgjedhje

102,691,667 Lekë

të ardhura



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR



TARGA ME PËRZGJEDHJE!



POROSIT TARGËN TËNDE ONLINE

- TARGA TË VEÇANTA
- TARGA JASHTË SERIE

www.dpshttr.gov.al




Figura III.4/3.a, neni 248





Figura III.4/4.a, neni 248





Errësimi i Xhamave të Mjetit

Si pasojë e kërkesës së lartë nga qytetarët për errësimin e xhamave të mjetit, “Miratimi dhe Certifikimi i Errësimit të Xhamave” të autoveturave filloi të aplikohet nga DPSHTRR në datën 1 Nëntor 2021. Errësimi i xhamave të mjetit duhet të realizohet me materiale të homologuara nga prodhuesi, të instaluara nga serviset e licencuara, duke respektuar përqindjet e lejuara të tejçueshmërisë së dritës, konform dokumentacionit që vërteton garancinë, faturimin dhe origjinën.

► Përfitimet nga errësimi i xhamave të automjetit!



Blllokojnë rrezet UV dhe IR të rrezikshme për shëndetin!



Sigurojnë në raste thyerje xhami!



Freski në ditë të nxehta!



Shikim më i mirë kundërvezullues!



Jetëgjatësi e interioreve!



Eko-konsum, kursim, ulje e ndotjes!



Siguri nga hajdutë kuriozë!



Krijon privatësi e komoditet!



► Në vitin 2021, janë realizuar:

79,758

**Certifikata
dhe miratime
për errësimin
e xhamave**

**197,223,333
Lekë**

• të ardhura



UNË TI

Targa Suvenir

Një pjesë e madhe e targave të vjetra me fushën e bardhë dhe simbolin e flamurit kombëtar me simbolin e shqiponjës, dolën jashtë përdorimit pas ndryshimit të formatit të targave shqiptare. Këto targa, nuk u hodhën ose shpërdoruan por u përdorën nëpërmjet Punishtes së Targave Suvenir nga projekti Retro Albania, duke i personalizuar me shkrime e dedikime sipas dëshirës, sigurisht jo për qëllime qarkullimi. Ky format është përdorur për dhurata të ndryshme dhe porosi personale të cilat porositen online ose prodhohen direkt në punishten lëvizëse të targave suvenir nëpër aktivitetet e Retro Tour. Fondet e fituara prej shitjes së tyre shkojnë për financimin e aktiviteteve e projekteve RETRO.

Në vitin 2021:

1,225 Targa Suvenir

1,531,250 Lekë

të ardhura






321,049

• **Shërbime Risi
në vitin 2021!**

Numri i 5 shërbimeve risi



+242,152

**Krahasuar me
vitin 2020!**



739,555,250 Lekë

të ardhura nga Shërbimet Risi
në vitin 2021!

+280%

800,000,000

700,000,000

600,000,000

500,000,000

400,000,000

300,000,000

200,000,000

100,000,000

739,555,250

194,801,083

**12 MUJORI
2020**

**12 MUJORI
2021**



4. SHËRBIMI I KONTROLLIT TEKNIK TË MJETEVE


Rikthimi i shërbimit të kontrollit teknik të mjeteve është shoqëruar me zgjatje të afateve të vlefshmërisë së Certifikatës së Kontrollit Teknik sipas kategorive të ndryshme të mjeteve. Janë krijuar lehtësira për qytetarët si: rezervim online të shërbimit me verifikim individual përmes portalit e-Albania, Certifikatë Kontrolli Teknik me QR Code për siguri e verifikim të lehtë kontrolli përveç barkodeve, investime në infrastrukturë shërbimi, në sisteme e pajisje duke përmirësuar ndërlidhjen e informacionit por edhe duke garantuar rrugë e qytete më të sigurta e më të pastra pasi mjetet e rrezikshme nuk e kalojnë dot më Testin e Kontrollit Teknik.

Qershor – Dhjetor 2021

Mjetet e Testuara sipas Ilojit

213,063 Mjete janë testuar mbi Kontrollin Teknik

69,9%
Automjete
(4 deri 8+1 vende)



19,6%
Kamion

5,3%
Motomjete


2,5%
Autobusë

2,2%
Rimorkio

0,5%
Mjete ndërtimi/punimi toke

60,120 Mjete janë ngelur/refuzuar!

91%



28,2% e Totalit të Mjeteve!


- **54,713** Mjete janë riestuar pas riparimeve
- **4,842** Mjete të ngelura që priten për t'u riparuar pas riparimeve
- **565** Mjete të refuzuara (xhama të dëmtuar, goma të tejkonsumuara, defekte e mangësi në sistem, mangësi në dokumentacion, etj)

Qershor – Dhjetor 2021

Arsyet e ngeljes së mjeteve (pas marrjes në testim):

49,2%

Mangësi vizuale
e funksionale



18,7%

Sistemi i frenimit

15,4%

Sistemi i shkarkimit të gazrave


16,7%

Sistemi i drejtimit, i përcjelljes së fuqisë në akse dhe i amortizimit

Arsyet e refuzimit për kontrollin teknik të mjetit:

76,3%

Xhama të dëmtuara, goma të tejkonsumuara, defekte e mangësi në sistem, mangësi në dokumentacion, etj.



10,8%

Problematika me dokumentacionin e errësimit të xhamave

7,4%

Problematika me aktivlerësimin e komoditetit


5,5%

Sistem drejtimi në krah të djathtë

Qershor – Dhjetor 2021

31% e Testimeve mbi Kontrollin Teknik të Mjetit janë kryer në DRSHTRR Tiranë

Numri i mjeteve të testuara sipas DRSHTRR-ve



5. RITJA E PERFORMANCËS NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME FOKUS QYTETARIN

Vëmendja te Qytetarët

Falë rikonceptimit financiar të shërbimeve, uljeve të tarifave, heqjes së procedurave dhe burokracive, i janë kursyer qytetarëve:

**446,466,808
Lekë**

21,299


**Ditë pune
kohë pritje**

Shërbimi	Kursim në Lekë	Kursim në Kohë
<ul style="list-style-type: none"> ■ Heqja e kontrollit fizik Zerim i tarifës prej 1,500 Lekë për 4 shërbime dhe eliminimi i shpenzimeve karburant për lëvizjen e mjetit. Kursim kohe procedura (20 minuta) dhe kursim kohe në trafik (40 min në trafik vajtje - ardhje). 	222,000,000	6,000,000
<ul style="list-style-type: none"> ■ Leje drejtimi/qarkullimi ndërkombëtare Vlefshmëria nga 1-3 vjet pa ndryshim tarife (-1,000 Lekë) dhe kursim karburanti. Kursim kohe procedura (20 minuta) dhe kohe në trafik (40 minuta në trafik vajtje - ardhje) për secilin nga dy vitet e ardhshme. 	94,437,760	3,096,320
<ul style="list-style-type: none"> ■ Zerimi i tarifës së regjistrimit dhe heqja e TVSH-së për mjetet elektrike. 	69,835,392	
<ul style="list-style-type: none"> ■ Ndërrimi i pronësisë së mjetit. Në sportelet tona me -70% të tarifës së noterëve dhe kursim karburanti. 	56,673,656	1,127,460
<ul style="list-style-type: none"> ■ CAP - Certifikatë Aftësie Profesionale. Zgjatja e afatit me uljen e tarifës me -43%. 	3,520,000	
Totali	446,466,808 Lekë	10,223,780 Minuta

Peshat e kursimit në lekë të shërbimeve të rikonceptuara

49,7%

Heqja e kontrollit fizik



21,2%
Leje drejtimi/qarkullimi ndërkombëtare

15%
Zerim i tarifës së regjistrimit të mjeteve elektrike + heqja e TVSH-së

12,7%
Ndërrimi i pronësisë së mjedit

0,7%
CAP - Certifikata e Aftësisë Profesionale





Digjitalizimi i Shërbimeve

Domosdoshmëria për përmirësimin e shërbimeve dhe përqasja e re drejt digjitalizimit të tyre përmes fjalës së fundit të teknologjisë, u përqendrua në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave për:

- Studimin e eksperiencës së qytetarëve në marrjen e shërbimit;
- Rishikimin e proceseve operacionale;
- Rishikimin e modeleve të aplikuara.



Në vitin 2018, sistemi karakterizohej nga:

- **Mungesë e ofrimit të shërbimeve online.**

Shërbimet të cilat ofroheshin në platformën e-Albania ishin vetëm katër. Faqja zyrtare nuk ofronte hapësirë për shërbime/aplikime online.

- **Procese operacionale të parashikuara në vite, duke mos lehtësuar shërbimin ndaj qytetarëve dhe kohën e marrjes së shërbimit.**

- **Mungesë e një sistemi ndërinstucional të integruar, në të gjitha nivelet e operimit, të cilat krijojnë ngurtësim të informacionit, kohë më të gjatë mbledhjeje, përpunimi dhe analizimi të të dhënave e si pasojë qytetari paguante në fund koston më të madhe.**

Krahas ndryshimeve në procedura në thjeshtimin e ofrimit të shërbimeve, u bë e mundur ajo që deri para pak muajsh dukej të ishte e pamundur: ofrimi i një pjese të madhe shërbimesh ONLINE pa nevojën e paraqitjes fizike duke eliminuar kohë, kosto lëvizje e duke luftuar korrupsionin!

► Digjitalizimi i proceseve: sistemi e-DPSHTRR

Një nga upgrade-t më të rëndësishme të zhvilluara në fund të vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021, ishte upgrade i sistemit e-DPSHTRR, ose siç njihet ndryshe, sistemi i të gjithë të dhënave dhe shërbimit të mjeteve të DPSHTRR.

Ideimi, zhvillimi dhe implementimi i këtij sistemi të integruar i cili bën të mundur ndërlidhjen e të gjitha drejtorive, mbledhjen e informacionit, ruajtjen dhe analizimin e saj, ishte një nga sfidat më të rëndësishme të vitit 2021.

Sistemi e-DPSHTRR mundëson:

- Automatizimin e shërbimeve të mjetit;
- Përmirësimin në raportim;
- Shërbim më të shpejtë ndaj qytetarëve;
- Ndjekje më të saktë të proceseve duke shmangur pasaktësitë dhe humbjen e të dhënave;
- Informacion në kohë reale.



Digjitalizimi i proceseve preku ndjeshëm dhe Drejtorinë e Targave dhe Shtypshkrimeve (DTSH) e cila prej vitesh kishte mbetur e painformatizuar. Një nga proceset e përditshme voluminoze të DTSH-së prej vitit 2019, ishte prodhimi i Targave me Përzgjedhje, (shërbim i cili u informatizua që nga procesi i aplikimit për targë nëpërmjet faqes web), adresimin për prodhim me anë të sistemit e-DPSHTRR, magazinimit të saj pastaj, në Drejtorinë Rajonale e deri në targimin e mjetit në sportel. I gjithë ky proces realizohet hap pas hapi nëpërmjet sistemit e-DPSHTRR duke shmangur çdo veprim manual.

► Aplikime online përmes web

Falë aplikimit online në web, qytetarët kanë përfituar gjatë vitit 2021:

8,511,930

Lekë të kursyera (nga eliminimi i paraqitjes në DRSHTRR përpara ndryshimit konstruktiv)

1,145

Ditë pune kohë e kursyer (mesatarisht 20 minuta për shërbim dhe 20 minuta rrugë)

687,000

Km rrugë të eleminuara (mesatarisht 50 km vajtje-ardhje/shërbim)

48,090

Lt karburant të kursyer (mesatarisht 7lt/100km rrugë/shërbim)





Shërbime në e-Albania

Sjellim më pranë qytetarëve 52 shërbime të DPSHTRR përmes platformës e-Albania, duke kursyer kohë në radhë, ardhje në sportele dhe burokraci.

Krahasuar me vitin 2020:

- **1,523,195** shërbime online ose +94% shërbime më shumë!
- Është dyfishuar numri i shërbimeve online të DPSHTRR-së të ofruara në e-Albania (nga 26 në vitin 2019 në 52 shërbime në vitin 2021)!


DPSHTRR renditet e para në rang vendi për numrin e shërbimeve e aplikimeve online të ofruara përmes e-Albania, që shënojnë 52 shërbime nga 4 që ishin në vitin 2018 pra nje rritje me +1,200% ose +18% krahasuar me vitin 2020.

Në 2019-2021, i janë kursyer qytetarëve:

238 vite kohë

617,240,813 Lekë

Numrat e shërbimeve ofruar në e-Albania, sipas viteve




Falë gjenerimit elektronik të dokumenteve pa ardhur më në radhë e sportele!

Në vitin 2021:

344,599

SHËRBIME ONLINE

Gjenerimi i dokumenteve me vulë elektronike



6. INTEGRIMI EVROPIAN I LEJES SHQIPTARE TË DREJTIMIT

Sistemet informatike, investimet më të fundit në implementim (upgrade eDM, eMONITORIMI dhe pajisjet e gjeneratës më të re), siguria e cilësisë së prodhimit të Lejes shqiptare të Drejtimit, si dhe rritja e sigurisë rrugore në Shqipëri sipas statistikave të viteve të fundit, ka mundësuar njohjen dhe konvertimin e Lejes shqiptare të Drejtimit në shtete të tjera.

DPSHTRR ka shënuar kthesë rrënjësore në digjitalizimin dhe modernizim e të gjithë shërbimit të marrjes së Lejes së Drejtimit, certifikimin dhe standardizimin, programet e pajisjet e reja, deri te monitorimi në kohë reale i Testit të Praktikës me kamera zë/figurë në automjet.

Republika e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje dypalëshe për njohjen e ndërsjelltë dhe konvertimin e lejeve të drejtimit me shtetet si më poshtë:



Italinë



Maqedoninë
e Veriut



Malin e Zi



Kosovën



Greqinë



Bullgarinë



Kroacinë




Gjermaninë*


* Pas ratifikimit në parlamentet e landeve, Bundesrati gjerman votoi njohjen dhe konvertimin e lejeve shqiptare të drejtimit, një lajm i rëndësishëm për dhjetëra mijëra bashkëkombas shqiptarë. Kjo njohje, e cila deri para disa vitesh as që mund të mendohej, certifikon transformimin rrënjësor të automotorizimit shqiptar, të konfirmuar prej misionëve të rrepta të inspektimit të qeverisë gjermane.

15,138

Shtetas shqiptar kanë
konvertuar Lejen kombëtare
të Drejtimit në të huaj gjatë
periudhës 2019-2021!



Lejet e drejtimit kombëtare shqiptare të konvertuara në të huaja gjatë vitit 2021 sipas shteteve



7. INVESTIME DHE INFRASTRUKTURA E SHËRBIMIT


Investime në drejtoritë rajonale

Krahas përmirësimit të ndjeshëm të shërbimeve, një rëndësi e veçantë i është kushtuar transformimit të kushteve të punës për punonjësit, ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve, unifikimit të brandimit, imazhit konform standardeve më të larta të shërbimit duke i dhënë DPSHTRR-së një fytyrë të re institucionale ku qytetari ndihet i mirëpritur.

Ky transformim ka nisur në vitin 2019 në të gjitha drejtoritë rajonale dhe në vitin 2021 ka spikatur investimi në DRSHTRR Tiranë, Berat, Laç, Sarandë, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër, Dibër dhe Lushnjë, si dhe në rikualifikimet e qendrave të kontrollit teknik të cilat vijojnë të jenë në proces.



PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE



DRSHTRR LAÇ

PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE



DRSHTRR KORÇË



PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE




DRSHTRR LUSHNJË

PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE




DRSHTRR DURRËS



DRSHTRR SARANDË



PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE



DRSHTRR SHKODËR

PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE



DRSHTRR GJIROKASTËR




PARA INVESTIMEVE



DRSHTRR VLORE





DREJTORIA E TARGAVE DHE SHYTPSHKRIMEVE

PARA INVESTIMEVE



PAS INVESTIMEVE



ARKIVI QENDROR




Selia 2 e DPSHTRR në Prezë

Në 2018-ën, selia qendrore po thyhej nga mbingarkesa. Ndërtime e shtesa pa leje, së bashku me tërmetet e 2019-ës kontribuan në listimin e kësaj godine për rrezik jete dhe bashkë me protokollet e pandemisë u detyruan 2/3 e personelit të distancohet. Fillimisht me qira ndërsa sot në kushte dinjitoze në një nga asetet më të reja të DPSHTRR-së, në Prezë, me një brandim të ri, sepse imazhi e kushtet e punës ndikojnë fuqimisht tek ekipi dhe tek qytetarët. Risim përditë vlerën e entit, cilësinë e shërbimeve, investimet infrastrukturore por edhe kreativitetin për identitet kulturor e bashkëkohor të automotorizimit shqiptar.



Investime të realizuara nga DPSHTRR (me vetëfinancim)

Investimet publike (Lekë)



1,171,709,964 Lekë

Realizimi i procedurave vjetore në investime publike nga DPSHTRR në vitin 2021!



Kursimi në Investimet Publike të DPSHTRR-së (me vetëfinancim):

Investime Publike të realizuara nga DPSHTRR me vetëfinancim!

Në vitet 2019-2021:

2,490,610,585

Lekë vlera e kontratave fituese në Investimet Publike nga DPSHTRR


320,918,866

Lekë kursyer nga Vlera e Fondit Limit (planifikuar në Investime Publike)

+ 11%

Kursimi nga Vlera e Fondit Limit (*Llogaritur sipas Manualit të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit*)

Investimet publike në vite (Lekë)



► **Më pranë qytetarëve**

Në krahasim me vitin 2018:

+76%


Mbulim i territorit me zyra shërbimi!

+325%

ose + 13 zyra të reja rajonale shërbimi

- HIMARË
- SKRAPAR
- POGRADEC
- GRAMSH
- LIBRAZHD
- KRUJË
- KAVAJË
- BULQIZË
- NSHRAK 3
- TEPELENË
- PËRMET
- KOMBINAT
- KAMËZ

Zyra Rajonale Shërbimesh sipas viteve



+347,233

Shërbime më pranë qytetarëve krahasuar me vitin 2018!

Kursyer qytetarëve:

17,361,650

Km rrugë vajtje-ardhje në total të eliminuara (mesatarisht 50 km për çdo zyre)


1,215,316

Lt. karburant

219

Milionë lekë kursimi total nga afrimi i shërbimeve

Shërbimet e ofruara në Zyra Rajonale sipas viteve




Transparenca mbi administrimin e buxhetit të DPSHTRR-së për prokurime/investime gjatë vitit 2021!

1,608,806,056 Lekë

Vetëfinancim i kontratave të investimeve, mallrave dhe shërbimeve nga DPSHTRR në vitin 2021!

Vetëfinancim i kontratave të investimeve në vite (Lekë)




Në vitin 2021:

97%

Realizimi i procedurave të planifikuara të prokurimit

Realizimi i Procedurave të Prokurimit në vite (%)



+29.3%

Realizim i procedurave të prokurimit krahasuar me vitin 2018!
(Përveç rasteve që procedura nuk varet nga DPSHTRR)


Investime në informatizim dhe pajisje nga DPSHTRR (me vetëfinancim)

Në vitet 2019-2021:

828,143,036 Lekë

(33%) Vlera në Investime për digjitalizimin,
sisteme operative, pajisje informatike nga DPSHTRR

Investimet sipas karakteristikës gjatë viteve 2019-2021
(%)



33%
Vlera e Investimeve
për Informatizim
dhe Pajisje

67%
Vlera e Investimeve
të tjera nga
DPSHTRR





Në vitin 2021:

442,903,652 Lekë

Vlera në Investime për digjitalizimin, sisteme operative, pajisje informatike nga DPSHTRR!

Investimet për Informatizim dhe Pajisje në vite (Lekë)



Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit:

Në vitet 2019-2021:

761

Operatorë ekonomikë pjesëmarrës në procedurat ekonomike të DPSHTRR


72%

E operatorëve pjesëmarrës kanë plotësuar kriteret e kualifikimit të procedurave të prokurimit

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit gjatë viteve 2019-2021 (%)


28%
E operatorëve ekonomikë të skualifikuar

72%
E operatorëve ekonomikë të kualifikuar



KAPITALIZIMI I ASETEVE TË DPSHTRR-së SIPAS VITEVE

Kapitalizimi i asetëve të DPSHTRR-së sipas viteve (Lekë)



 Mbi dyfishim i vlerës së asetëve të DPSHTRR-së krahasuar me vitin 2018!

Në vitin 2020:

517,105,159

lekë rivlerësimi i asetëve të DPSHTRR

16%

vlera e rivlerësuar e kapitalizimit të asetëve

8. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun, trajtimi i ankesave

Synimi kryesor i DPSHTRR-së është të jemi sa më pranë qytetarëve në çdo moment që ata kanë nevojë për informacione të ndryshme rreth shërbimeve tona. Angazhimi i ekipit për të asistuar me informacione, për t’ju përgjigjur çdo pyetjeje, sugjerimi apo ankesë adresuar në të gjitha kanalet tona të komunikimit, ka qenë maksimal duke e renditur DPSHTRR-në si një nga institucionet më aktive në të gjitha platformat online, më të hapura dhe transparente në komunikimin me qytetarët, e duke transformuar tërësisht imazhin e dikurshëm të institucionit.

Frymë e re ndërveprimi me publikun

Në vitin 2018, ishte e nevojshme rijetëzimi i komunikimit me qytetarët për t’ju përafuar nismave të digjitalizimit të shërbimeve. Në një hark kohor 3-vjeçar, është punuar intensivisht për të përmirësuar përgatitjen e informacionit, shpërndarjen e tij në sa më shumë kanale komunikimi, monitorimin e cilësisë së shërbimit në sportel, adresimin e ankesave dhe përhajtimin e kthimit të përgjigjeve. Ky proces ndryshimi ilustruhet përmes krahasimit më poshtë:


SI ISHTE 2018	SI ËSHTË 2021												
<p>Kontakt i pakët virtual me qytetarët. Mosfunksionim i hapësirave ankimuese apo denoncuese nuk krijonte mundësinë e një marrëdhënie më të qartë dhe të afërt me qytetarët në marrjen e reagimit të tyre mbi cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe marrjen e masave për përmirësimin e tyre.</p>	<p>39,469 Ndërveprime/Asistencë në shërbim të qytetarëve/subjekteve!</p> <p>+689% më krahasuar me vitin 2018!</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kanali i komunikimit</th> <th>Nr. i komunikimeve vjetore</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Telefonata/ Whatsapp</td> <td>30,351</td> </tr> <tr> <td>Rrjete Sociale</td> <td>3,786</td> </tr> <tr> <td>Web & Mail</td> <td>5,175</td> </tr> <tr> <td>Platforma Denonco</td> <td>184</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>39,469</td> </tr> </tbody> </table>	Kanali i komunikimit	Nr. i komunikimeve vjetore	Telefonata/ Whatsapp	30,351	Rrjete Sociale	3,786	Web & Mail	5,175	Platforma Denonco	184	Totali	39,469
Kanali i komunikimit	Nr. i komunikimeve vjetore												
Telefonata/ Whatsapp	30,351												
Rrjete Sociale	3,786												
Web & Mail	5,175												
Platforma Denonco	184												
Totali	39,469												

SI ISHTE 2018**FAQJA ZYRTARE
WWW.DPSHTRR.GOV.AL
KISHTE:**

- Mangësi në dizajn dhe në përmbajtje;
- Ngarkim të ngadaltë të faqes (shpejtësia e ngarkimit 17.4s);
- Faqja kryesore jo e organizuar dhe me një arkitekturë të ndërlikuar të ofrimit të informacionit;
- Dizajni i faqes i papërshtatshëm për t'u aksesuar nga celulari;
- Faqe jo e optimizuar për t'u gjetur me anë të motorëve të kërkimit si google, etj;
- Mangësi në link-s që të cojnë nga një faqe në tjetrën;
- Mungesa e një webchat të dedikuar për komunikimin me qytetarët;
- Vizitueshmëria mesatare ishte 50 individë/ditë;
- Vizitueshmëria vjetore ishte 18,250 individë.

SI ËSHTË 2021**FAQJA ZYRTARE
WWW.DPSHTRR.GOV.AL
KA:**

- Lehtësisht e aksesueshme, informacione të përditësuara e të thjeshtuara;
- Shpejtësi e lartë e ngarkimit të faqes.
- Përmirësim i shpejtësisë së ngarkimit të faqes me 78% (nga 17.4s në 3.7s);
- Strukturë informacioni e mirëorganizuar në menu dhe nënmenu, butona shërbimesh në faqen kryesore, opion i kërkimit me fjalë kyçe;
- Faqe e përshtatshme për t'u aksesuar në celular (mobile friendly). Rreth 80% e përdoruesve e aksesojnë faqen përmes celularit;
- Motor kërkimi efektiv. Përcaktimi i fjalëve kyçe gjatë procesit të hedhjes së informacionit në Web krijon mundësinë e një kërkimi më efektiv dhe të shpejtë nga ana e përdoruesit duke ulur ndjeshëm kohën e navigimit në faqe;
- Webchat i dedikuar për komunikimin direkt me qytetarët, opion që shfaqet në faqen e parë dhe në faqet e tjera;
- Vizitueshmëria mesatare është 1,130 vizitorë/ditë (+2,160% më shumë krahasuar me vitin 2018);
- Vizitueshmëria vjetore është 412,349 vizitorë (+2,159% më e lartë krahasuar me vitin 2018).

**Vizitueshmëria vjetore në
www.dpshttr.gov.al**

SI ISHTE 2018**PREZENCË POTHUAJSE INEKZISTENTE NË PLATFORMAT SOCIALE**

Përveç llogarisë në Facebook, DPSHTRR nuk kishte llogari në rrjete si: Whatsapp, Instagram, Youtube, Twitter, Google, etj.

Mungonte qendërimi i informacionit.

Çdo drejtori rajonale kishte numrin e saj të telefonit dhe adresën e vetë të e-mail ku qytetarët kontaktonin, ku institucioni qendror nuk ishte në dijeni sa kërkesa/telefonata vinin në çdo drejtori rajonale dhe si trajtoheshin këto kërkesa. Shumë nga numrat e telefonit nuk ishin funksionalë ose nuk përgjigjeshin, ndonëse kontaktet ishin të vendosura në faqen zyrtare duke krijuar mjaft problematika në drejtorinë qendrore.

Burokraci në komunikim dhe vonesa në kthim përgjigje.

Komunikimi me qytetarët ishte i vështirë duke mos adresuar kërkesat në kohë, duke vonuar në përgjigje e duke kthyer përgjigje formale të cilat shpesh nuk reflektonin zgjidhje të kërkesës së tyre, por që i linin qytetarët edhe me më shumë pyetje duke krijuar mosbesim ndaj institucionit.





Mungesë anketimesh për cilësinë e shërbimit në sportel.

Për të kuptuar cilat janë pyetjet më të shpeshta, informacionet më të kërkuara, problematikat në kontaktet me sportelet, nevojiten anketime nga vetë institucioni për të kuptuar ku duhet përmirësuar komunikimi e shërbimi.

Roja si zyrë informacioni.

Një nga problemet më të mëdha në shërbimin e drejtorive rajonale ishte mungesa e sporteleve ose punonjësve të informacionit për të orientuar qytetarët mbi shërbimet, funksion i cili mbulohej kryesisht nga rojet të cilët blloktonin dyert duke diktuar te radha.

SI ËSHTË 2021**PREZENCË AKTIVE NË PLATFORMAT ONLINE:**

	DPSHTRR	RETRO
	28,772	10,846
	6,946	10,200
	1,890	1,139
	309	306

Komunikim qendror për të gjitha telefonatat/e-mailet/kërkesat për informacion.

Të gjitha komunikimet menaxhohen nga Njësia e Marrëdhënieve me Publikun në DPSHTRR, e cila mbledh, përpunon, kthen përgjigje për qytetarët dhe ndërlihd komunikimin me të gjitha drejtoritë rajonale, duke ndjekur të gjitha etapat deri në dhënien e informacionit dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Komunikim direkt përmes kanaleve të komunikimit, edhe në trajtë chati.

Përgjigjet kthehen në formë të shpejtë, në trajtë komunikim chati në kohë reale duke shmangur burokracitë e e-maileve. Kjo mundëson një ndërveprim shumë të lartë me qytetarët, duke e kthyer komunikimin me qytetarin në trajtë më miqësore ku ai ndihet i vlerësuar, i respektuar dhe i konsideruar.

Zëri Yt Dëgjohet!


Krahas anketimeve të jashtme, DPSHTRR ka ndërmarrë fushatën “Zëri Yt Dëgjohet”, një nismë që ka si qëllim plotësimin e një pyetësori mbi cilësinë e shërbimit në sportel dhe sugjerimeve për përmirësimin e mëtejshëm.

Sportele informacioni dhe sisteme radhe.


Kultura e pritjes së qytetarëve në drejtoritë rajonale ka pësuar një ndryshim të madh, ku për çdo pyetje mbi shërbimet, mund të drejtohen në sportelet e informacionit e të tërheqin kuponin e pritjes në radhë. Gjithashtu, për drejtoritë me fluks të madh shërbimi si Tirana dhe Durrësi, qytetarët mund të rezervojnë takimin online në sportel në faqen zyrtare: www.dpshttr.gov.al

Rritja në numër e telefonatave përgjatë vitit 2021, ka ardhur jo vetëm për shkak të rritjes së profesionalizmit dhe transparencës në trajtimin e ankesave, gjë që tregon për një rritje të besueshmërisë së publikut ndaj shërbimit, por edhe prej rikthimit të shërbimit të Kontrollit Teknik si shërbim i DPSHTRR-së, ku qytetarët informohen më tej për procedurat në numrin zyrtar.

Prezenca jonë online sa vjen dhe rritet me informacione dhe publikime për të gjitha shërbimet tona. Gjatë vitit 2021, janë realizuar rreth 41,163 publikime informuese, rreth 973% më shumë krahasuar me vitin 2019 dhe 59% më shumë krahasuar me vitin 2020.



Publikime informuese dhe aplikime online në WEB (DPSHTRR & RETRO & TASKFORCA)





OPEN DATA

Kërko, krahaso, analizo!

Open Data DPSHTRR është një platformë e cila i ofron për herë të parë publikut akses në të dhëna statistikore dhe grafika të ngritura në trajtë shifrash dhe përqindjesh. Të dhënat janë mbi: regjistrimin e mjeteve dhe lejeve të drejtimit, mbi sigurinë rrugore dhe shërbimet e DPSHTRR-së, që ndihmojnë individët, subjektet dhe institucione të ndryshme, brenda e jashtë Shqipërisë, për qëllime kërkimore dhe studimore, në proceset e formalizimit të ekonomisë bazuar në të dhëna të sakta. Informacione të vlefshme për politikëbërësit, grupet e interesit, biznesin dhe investitorët, në ndihmë të mirëplanifikimit, analizave sektoriale, klientëve e partnerëve.

VITI 2021:

- **10,485** faqe vizituar, krahasuar me 5,004 në vitin 2020 (ose +100%);
- **1,318** përdorues kanë pasur akses, nga 425 përdorues në vitin 2020 (ose +210%);
- **2,500** vizita gjatë vitit 2021;
- **23** numri i shteteve të origjinës së përdoruesve;
- **4** numri i kontinenteve të origjinës së përdoruesve.

Open Data u rikonceptua dhe automatizua duke pasuruar të dhënat statistikore dhe duke krijuar mekanizma automatike krahasimore për periudha të ndryshme.

Ky ndryshim rriti ndjeshëm interesin e përdoruesve, veçanërisht për tregtarët dhe koncesionarët e mjeteve për të cilët tashmë Open Data është kthyer në një pikë referimi për studimin e tregut. Gjithashtu, edhe INSTAT i referohet kësaj databaze për publikimin e statistikave zyrtare.




9. E-TRANSPORT E ARDHMJA DIGJITALE E TRANSPORTIT RRUGOR NDËRQYTETËS TË UDHËTARËVE!

Për herë të parë në Shqipëri, kjo platformë risi do të menaxhojë e monitorojë fluksin e udhëtarëve në linjat e transportit ndërqytetës, për gati 50 milionë bileta udhëtimi në vit. Përfitojnë qindra agjenci, mijëra të punësuar e miliona pasagjerë!

FALAS për të gjithë aktorët e përfshirë:

- 520 linja
- 242 operatorë
- 2,282 mjete



Çfarë mundëson e-Transport?



- Lehtësi dhe praktikitet në përdorim për udhëtarët dhe subjektet;
- Motor për agjencitë, robotët biletashitës, me linjat oraret, ulëset, stacionet dhe tarifrat;
- Servera dhe databazë elektronike;
- Sportel online për shërbimet;
- E aksesueshme për turistët e huaj;
- Modul biletimi elektronik:
 - Online (përmes aplikacionit dhe faqes zyrtare);
 - Në autobus;
 - Në agjenci.
- Analiza, raporte dinamike në funksion të incentivave për sektorin;
- Ulje kostosh operative, maksimizim i kapaciteteve;
- Eliminim informaliteti, mbrojtje e rrjetit të linjave;
- Monitorim në kohë reale të lëvizjeve të flotës;
- Lehtësi për pasagjerët me paketa sociale, duke garantuar verifikim digjital.



Përmirësim rrënjësor i eksperiencës së udhëtimit në Shqipëri!

10. TASK-FORCA E TRANSPORTIT RRUGOR

Task-Forca e Transportit Rrugor është krijuar me VKM nr 465 datë 26.7.2018 “Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”, i ndryshuar, dhe organizuar në bazë të Urdhërit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr. 648, datë 21.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Task-Forcës”.

Task-Forca e Transportit Rrugor si e vetmja strukturë rregullatore dhe ligjzbatuese e këtij lloji në Republikën e Shqipërisë, e përbërë nga 40 punonjës ushtron kontroll në 12 Qarqet e Shqipërisë për zbatimin e ligjshmërisë së aktivitetit në shoqëritë e transportit rrugor të pasagjerëve dhe mallrave.



Objekt i punës së Task-Forcës së Transportit Rrugor është lufta kundër informalitetit dhe paligjshmërisë, pa anashkaluar dhënien e rekomandimeve dhe zgjidhjeve të problemeve të ndryshme që lidhen me transportin e udhëtarëve dhe mallrave.

Struktura e Task-Forcës në funksion të aktivitetit të saj, mbështetet tërësisht nga buxheti i DPSHTRR-së, duke përfshirë pagat, dietat, logjistikën e nevojshme, automjete, pajisje kompjuterike, pajisje të tjera të nevojshme për kontrollin në rrugë, peshore për matjen e peshave, tabletave për verifikimin online të çdo dokumenti, kamerat e suportit për monitorimimn e procedurave të kontrollit me zë dhe figurë, etj.

Në kuadër të veprimtarisë së tyre gjatë periudhës 2019-2021, grupet e inspektorëve të autorizuar në Drejtorinë e Kontrollit në Terren, pranë Task-Forcës së Transportit Rrugor kanë mbajtur një numër prej **9,792** Akte Konstatimi, të cilat i janë dërguar për shqyrtim Komisionit të Shqyrtimit të Masave Administrative. Problematikat më të shpeshta të evidentuara janë:



Taksi pa licencë;



Qarkullim pa faturë shoqërimi të mallit;



Mbipesha e mjeteve;



Qarkullim pa certifikatë transporti;



Ndryshim destinacioni;



Qarkullim pa kontroll teknik vjetor etj.



11. AUTOMOTO PARK ALBANIA



Automoto Park Albania, një ëndërr e shumëpritur së shpejti realitet! Një hap historik për automotorizimin shqiptar dhe aktivitetet automobilistike, si dhe për promovimin e kulturës së motorsportit!

Cirkuiti i parë shqiptar me pistë ~5.3 km dhe një sipërfaqe prej 500,000+ m² në qytetin e Elbasanit sipas standardeve të FIA, FIM dhe CIK. Edhe si qendër eventesh indoor dhe outdoor, muzeu e atelieri RETRO, drag strip me gjatësi 1.2 km në kushte sigurie, autodrom dhe kartodrom i parë i homologuar, akademi motosporti dhe akademja e edukimit mbi sigurinë rrugore, poligone profesionale testimi, pistë offroad, helipad dhe zonë sportive mjetesh ajrore ultra të lehta! Investimi përfshin edhe kompleksin e ri të DRSHTRR Elbasan me Qendrën e re të Kontrollit Teknik (kolaudimi), dedikuar shërbimeve të transportit rrugor.

Projekti do të financohet nga fondet e DPSHTRR-MIE në bashkëpunim me Bashkinë e Elbasanit dhe me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare.

Pista:

- Shtrirja 500,000 m²;
- Gjatësia maksimale 5,300 metra;
- Trajektorja kryesore 3,790 metra;
- Profili tërthor 20 metra;
- Gjatësia e vijës së drejtë (Starti) 1,000 metra;
- Vendndodhja Elbasan, Shqipëri.



Automotopark Albania, do të jetë gjithashtu një hapësirë ku të gjithë dashamirësit e aventurave në timon mund të testojnë aftësitë e tyre.

12. BURIMET NJERËZORE



Vende të reja pune

Një aspekt i rëndësishëm dhe motori lëvizës i një institucioni, janë punonjësit e tij. Falë stafit të mirëmotivuar, të përkushtuar dhe profesional, DPSHTRR ka mundur të arrijë rezultate rekord në shërbime e të ardhura përgjatë viteve të fundit. Këtë vit, pjesë e strukturës së DPSHTRR-së, iu shtua ekipi i shërbimit të kontrollit teknik, si shërbim risi. Krahas punonjësve të DPSHTRR, falë kontratave të investimeve dhe funksioneve të reja profesionale, janë mbështetur edhe qindra punonjës të operatorëve ekonomikë, duke kontribuar në ekonominë e sektorëve.

1,034 Vende pune në DPSHTRR gjatë vitit 2021



krahasuar me vitin 2020!




krahasuar me vitin 2019!



krahasuar me vitin 2018!

30%
Të punësuar
direkt nga
DPSHTRR



70%
Të punësuar
në mënyrë
të mbështetur
nga DPSHTRR

Në vitin 2021:

3,474

të punësuar në mënyrë direkte ose të mbështetur nga DPSHTRR (projeksion)

1,034 Vende pune në DPSHTRR gjatë vitit 2021

LLOJI I PUNËSIMIT

Tek Operatorët ekonomikë mbështetur nga kontratat e investimeve

Funksione të reja profesionale falë Shërbimeve Risi (Certifikime dhe Miratime për Errësimin e Xhamave)

Në mënyrë direkte në DPSHTRR

TOTAL


NUMRI I PUNËSIMEVE

2,030

410

1,034

3,474



- Vende pune në DPSHTRR
- Vende pune mbështetur nga DPSHTRR nëpërmjet funksioneve të reja profesionale
- Vende pune mbështetur nga DPSHTRR nëpërmjet investimeve

7,486

Paga nga operatorët ekonomikë mbështetur nga DPSHTRR me anë të investimeve sipas kontratave të tregut dhe funksioneve të reja profesionale (për periudhën 2019-2021).



Praktika profesionale



Për të gjithë studentët e interesuar për të zhvilluar praktika profesionale, DPSHTRR ofron praktika me afate 15-ditore, 1-3 mujore, si një mundësi shumë e mirë për të përfituar përvojën e punës. Zhvillimi i praktikës së punës është pa pagesë dhe qëllimi mbetet përfitimi i një përvoje kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale. Gjatë zhvillimit të praktikës, praktikantët realizojnë detyra dhe angazhime në sektorët ku caktohen, bazuar në një

plan pune, të drejtuar nga një mbikqyrës. Pas përfundimit të praktikës, praktikantët pajisen me një certifikatë pjesëmarrjeje.

Gjatë vitit 2021, 15 praktikantë të cilët janë interesuar drejtpërdrejtë, kanë zhvilluar praktikën në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Drejtoritë Rajonale. Ndërkohë 3 praktikantë të tjerë, kanë aplikuar nëpërmjet Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, për të zhvilluar praktikën, ku një prej këtyre praktikantëve është punësuar tashmë në Drejtorinë Rajonale Tiranë.

Që nga viti 2019 deri në fund të vitit 2021, kanë zhvilluar praktikën pranë DPSHTRR-së dhe Drejtorive Rajonale 38 praktikantë.

Për të gjithë studentët e interesuar për të zhvilluar praktika profesionale dhe për mundësi punësimi, DPSHTRR-së ishte pjesë e Panairit të Punës dhe të Karrierës, në Fakultetin e Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" në Durrës, ku u njohëm me dhjetëra studentë të interesuar për të kryer praktikën profesionale pranë nesh, për t'u dhënë një mundësi të mirë të rinjve për t'u prezantuar me tregun e punës dhe përfaqshen me fushën automotive, gjithashtu edhe për ne për t'u njohur nga afër me të rinj të motivuar e të talentuar si një motor i ri zhvillimi në sektorin publik.





Shëndeti i Punonjësve: Paketa Sociale, COVID dhe Masat në Sportele

Ashtu si në vitin 2020, edhe gjatë vitit 2021 veprimtaria institucionale e DPSHTRR-së u ndikua nga një sërë faktorësh e rrethanash të lidhura me pandeminë Covid-19.

Masat anti-covid u zbatuan me përpikmëri, për të shmangur infektimin ndërmjet punonjësve dhe për të ndërprerë një zinxhir të mundshëm të transmetimit që mund të formohej midis punonjësve në sportel dhe qytetarëve shërbim marrës.

Përgjatë vitit 2021, në DPSHTRR janë konfirmuar 150 raste pozitive, pra rreth 15% e punonjësve të gjithë DPSHTRR-së dhe fatkeqësisht është shënuar edhe 1 vdekje e shkaktuar nga COVID-19. Piku i infektimeve ishte në muajin Shkurt me 47 raste pozitive.

Duke qenë një autoritet publik që ofron 2.7 milionë shërbime në sportel në fushën e transportit rrugor, ku kontakti i drejtpërdrejtë me qytetarët është i pashmangshëm, DPSHTRR në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mundësoi përfshirjen e punonjësve të DPSHTRR-së dhe instruktorëve të autoshkollave në grupet prioritare për t'u vaksinuar. Që nga fillimi i fushatës së vaksinimit deri në Dhjetor 2021, rreth 92% e stafit të DPSHTRR-së dhe Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor janë të imunizuar nëpërmjet vaksinimit.

DPSHTRR është bërë pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit, duke u bërë thirrje të vazhdueshme qytetarëve për vaksinimin dhe për zbatimin e masave anti-covid.

Një nismë e re që u ndërmorr nga DPSHTRR ishte bashkëpunimi me Urgjencat Kombëtare për të trajnuar një pjesë të stafit për të dhënë ndihmën e parë në raste emergjencash. Ky plan do të zhvillohet më gjerë gjatë vitit 2022 së bashku me sigurimin e kutive të ndihmës së shpejtë për punonjësit dhe për qytetarët që marrin shërbim në sportelet tona.



Projekte Edukative për Sigurinë Rrugore

Të motivuar e të përkushtuar për të përmirësuar kulturën automotive e për të sjellë një frymë ndryshimi në përqasjen e drejtimit të mjetit dhe të njohjes e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor në Shqipëri, prej vitit 2020, si DPSHTRR kemi ndërmarrë një sërë nismash të cilat i përgjigjen fushatës për planifikim-veprim mbi sigurinë rrugore.

Këndi Edukativ i Sigurisë Rrugore

Edukimi rrugor për të njohur tabelat dhe rregullat bazë të qarkullimit rrugor, duhet të nisi që në fëmijëri përmes lojës interaktive e argëtimit, për një të nesërme më të sigurt e breza më të ndërgjegjshëm e të përgjegjshëm në rrugë.

Këndi edukativ i Sigurisë Rrugore është kthyer tashmë një orë edukative e përjavshme në shumë qytete të Shqipërisë, ku DPSHTRR në bashkëpunim me mësuesit, shkollat dhe bashkitë e ndryshme, improvizojnë rrugën me të gjithë elementët e saj, si dhe zhvillojnë orë aktive edukative mbi sigurinë rrugore.



70
Evente
Edukative



14
Qytete



5000
Fëmijë
Pjesëmarrës

• Këndi Statik i Sigurisë Rrugore në Shkollën Industriale “Pavarësia”

Krahas dhjetëra aktiviteteve të Këndit të Sigurisë Rrugore të cilat kanë shëtitur në qytete të ndryshme të Shqipërisë, DPSHTRR ka realizuar investimin për të parin Kënd Statik të Sigurisë Rrugore në ambientet e jashtme të shkollës së mesme industriale “Pavarësia”, Vlorë, ku nxënësit mund të mësojnë rregullat e qarkullimit rrugor dhe këshillat mbi sigurinë rrugore në hapësirën e posaçme që simulon një qytet të vogël me sinjalistikat e duhura rrugore. Ky investim është përkrahur nga mësuesit, shkollat dhe prindërit e do të shtrihet si një nismë ku do të ftohen dhe nxitet pjesëmarrja edhe nga qytete të tjera të Shqipërisë duke i mundësuar fëmijëve të gjithë infrastrukturën e nevojshme edukative e mësimore.





Botime dhe Broshura Edukative

Domosdoshmëria për materiale edukative mbi sigurinë rrugore, ka shtyrë DPSHTRR të krijojë dhe botojë përmbledhje me koncepte bazë për edukimin rrugor sipas grupmoshave të ndryshme duke filluar që nga fëmijët me botimin “Luajmë me hapa të sigurt”, i cili shpërndahet në çdo aktivitet, materiale edukative për fëmijët e shkollave 9-vjeçare dhe udhëzues për mësuesit në bashkëpunim me drejtoritë arsimore dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për t’i kthyer këto manuale si pjesë të kurrikulave mësimore.

Krahas edukimit të fëmijëve, DPSHTRR ka përgatitur për herë të parë Manualin e Përgatitjes për Testimin Teorik, një botim zyrtar që përmban të gjitha njohuritë e nevojshme teorike mbi qarkullimin rrugor, tabelat dhe sinjalistikat rrugore, situatat e rrugës dhe si duhet të sillemi në trafik, si dhe koncepte me rëndësi për sigurinë rrugore për kandidatët për marrjen e lejes së drejtimit.

Gjithashtu, DPSHTRR ka përgatitur dhe një libërth për normat e sjelljes rrugore për të gjithë drejtuesit e mjeteve të cilët kanë kryer shkelje të Kodit Rrugor dhe që përpara rinovimit të lejes së drejtimit, do i nënshtrohen fillimisht një testi të shpejtë (quiz) për konceptet bazë të sigurisë rrugore. Pas testimit, drejtuesit e mjeteve do të pajisen me libërthin dhe në rast se nuk do e kalojnë testin, do të marrin pjesë në një orë mësimore dhe edukative mbi konceptet e sigurisë rrugore. Ky libërth do të mundësohet pa pagesë për drejtuesit e mjeteve me qëllim ndërgjegjësimin për të udhëtuar të sigurt e për të treguar kujdes në rrugë, për veten, pasagjerët dhe përdoruesit e tjerë të rrugës.







Promovimi Online dhe Emisione Edukative

Komunikimi online me publikun dhe rrjetet sociale janë kthyer në një nga format më të përdorura për përcjelljen e informacioneve në kohë reale. Për këtë arsye, DPSHTRR promovon përmes platformave online: klipe edukative në trajtë animacionesh, video infografikash, postera sensibilizues, por edhe përmes emisioneve edukative në televizione (emisioni “N’Timon”, Top News Albania).

Të gjitha materialet e përgatitura nga DPSHTRR, krahas publikimit në një faqe të dedikuar për sigurinë rrugore në www.dpshttr.gov.al, gjenden në të gjitha kanalet tona në rrjetet sociale: Facebook, Instagram, Youtube, Twitter dhe së fundmi TikTok si një mundësi për të shpërndarë mesazhet ndërgjegjësuese te një audiencë më e re.



14. KOLEKSIONI SHQIPTAR RETRO

Shërbimi dhe Komisioni Retro

RETRO është projekt i nisur nga DPSHTRR në vitin 2019 për të gjithë automjetet dhe ciklomotorët, të lënë në harresë, që përcaktoheshin me termin “të vjetra” e duke mos u vlerësuar. Çështje dhe problematika me interes që sollën krijimin e Koleksionit Shqiptar Retro ishin: regjistrimi i mjeteve historike, taksat e larta, mungesa e dokumentacioneve, homologimi i mjeteve, etj. Pasioni për mjetet historike dhe dëshira për të krijuar dhe dokumentuar një kulturë të automotorizimit në Shqipëri është pika lidhëse që bashkon të gjithë grupet e interesit që prej fillimit.

Të gjithë të interesuarit që duan të importojnë ose blejnë mjete me të cilat do të aplikojnë për status Retro, duhet të njihen domosdoshmërisht me Listën e Mjeteve Historike. Lista e Mjeteve Historike dhe Lista e Mjeteve “Future Classics”, janë shpallur dhe publikuar në faqen zyrtare Retro.al në vitin 2021 dhe shërbejnë për importin e mjeteve historike nga jashtë.

Lista e mjeteve historike, përditësuar për vitin 2022, përmban mjetet me vit prodhimi midis 1970-1991 si referim zyrtar për aplikimet që Komisioni Zyrtar i Vlerësimit pranon, ndërsa Future Classics përmban mjetet me vit prodhimi 1991-2001, që nuk kanë arritur ende vjetërsinë për të vijuar me procesin e përfshirjes në Regjistrin e Mjeteve Historike.



Verifikime nga Komisioni RETRO

Duke filluar nga Qershori 2020 deri në Dhjetor 2021, janë verifikuar nga Komisioni RETRO 446 mjete, prej të cilave 226 të verifikuara në vitin 2021. Kanë fituar statusin e mjetit historik 334 mjete në total.

- Qershor 2020 - Citroen 2CV Spacek, viti 1975 - makina e parë e verifikuar nga Komisioni Retro;
- Tetor 2020 - Vespa 150 GL, viti 1963 - Vespa e parë e verifikuar nga Komisioni Retro;
- Tetor 2020 - Volkswagen Beetle 1200, viti 1975 - mjeti i 100-të që pajiset me targat Retro.

Nga Janar 2021 - Dhjetor 2021 janë kryer në total 226 verifikime dhe janë targuar 189 mjete, ku prej tyre 117 janë motomjete të verifikuara dhe 110 motomjete të targuara me targat e posaçme Retro. Marka më frekvente ndër këto verifikime ka qenë Mercedes-Benz për automjetet dhe Vespa për motomjetet, ndërsa qyteti me më shumë verifikime është Tirana.

Janar 2021 - Dhjetor 2021

Verifikime në total	226
Motomjete të verifikuara	117
Mjete të targuara	189
Automjete të targuara	79
Motomjete të targuara	110
Marka më frekvente për automjete:	MERCEDES-BENZ
Marka më frekvente për motomjetet:	VESPA

“Statusi i veçantë” nënkupton ofrimin e lehtësirave për këto mjete si përjashtimi nga taksat e luksit, ndalesat e importit lidhur me kategorinë mjedisore, përjashtimi nga taksa vjetore e qarkullimit, nga taksat mjedisore, si dhe nga kontrolli teknik periodik.



Sot anëtarësimi në klubin e diskutimit Retro arrin mbi 3,500 anëtarë në mbarë botën. Selia e klubit është në Tiranë, por në thelb, RETRO është kudo ku festohen mjetet historike.



RETRO Tour

Eventet Retro janë shfaqjet kryesore kombëtare dhe rajonale për mjetet historike ku nëpërmjet tyre njihemi edhe me klubet ekzistuese në rajon dhe ndërkombëtarisht. Nuk është e nevojshme të zotërohet një mjet historik për të marrë pjesë në aktivitetet e Retro Tour. Koleksioni automobilistik shqiptar është kthyer në traditë turistike e kulturore në qytete të ndryshme të Shqipërisë si Tirana, Korça, Shkodra, Durrësi, Vlora, Gjirokastra, Pogradeci, etj.

Fuqia promovuese e botës së automobilizimit në turizëm dhe në industrinë e eventeve, ka zgjuar interes edhe tek bizneset e shoqatat. Ndryshe nga pak vite më parë kur këto mjete dhe kjo kulturë ishin lënë në harresë, mjetet historike kërkohen tanimë si atraksion për aktivitete të ndryshme, për krijimin e materialeve multimediale artistike dhe promocionale dhe gjithashtu për edukimin e profesionistëve të rinj në restaurim.



Katalogu Retro

Risi e këtij viti ishte edhe botimi i Katalogut Retro, sjellë përmes një teksti dygjuhësh shkruar në shqip dhe anglisht, kushtuar entuziastëve të automobilizimit dhe copëzave të historisë së tij në Shqipëri. Në këtë publikim, koleksioni rrëfëhet me pamje e përshkrime për shumë mjete që kanë lëvizur në vendin tonë, gjithashtu sipas përjetimeve të shqiptarëve lidhur me

automotorizimin, me fotografi nostalgjike nga e përditshmja e një shekulli automotorizim shqiptar.

Kërkimi nga arkivat e nga kinematografia shqiptare, shpalosi shumë sekuenca dhe narrativa të reja që përbëjnë këtë histori të automobilizimit në vendin tonë. Ky botim është tashmë në shitje, prej datës **17 Dhjetor 2021** në libraritë Adrion Ltd.



15. PËRGJEGJËSIA SOCIALE



Solidariteti ndaj personave në nevojë

Një nga ndjesitë pozitive më të forta në DPSHTRR është solidariteti si ekip ndaj personave më në nevojë. Në vitin 2021, ekipi ynë u solidarizua për të kontribuar financiarisht dhe vullnetarisht në dy raste familjesh që jetonin në kushte shumë të vështira, duke e çuar në 3 totalin e shtëpive të ndërtuara!

•Familja Kraja në Shkodër

Falë nismës së DRSHTRR Shkodër dhe apelit të Star Plus TV, të gjithë punonjësit e DPSHTRR-së u bashkuan për të dhuruar ndihmë monetare në ndërtimin e një banese për një familje e cila prej 20 vitesh jetonte në kushte të papërbalueshme e me probleme shëndetësore.

Tashmë, familja Kraja gëzon shtëpinë e re dhe kushte dinjitoze për të jetuar!



•Familja Haxhiaj në Tiranë

Një shtëpi e rindërtuar nga themelet për familjen Haxhiaj, Tiranë, e cila jetonte në kushte mjaft të vështira. Për ndërtimin e kësaj shtëpie, u mbledhën vullnetarisht nga punonjësit tanë (dr. rajonale + zyra qendrore) 3,283,300 Lekë!



Dhuro Gjak, Shpëto Jetë!

Ekipi i DPSHTRR dhe DRSHTRR Tiranë e Durrës, i janë bashkuar nismës humane të Kryqit të Kuq Shqiptar për dhurimin e gjakut, si një kontribut i domosdoshëm për t'i ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë.



Mbjellje pemësh!

Një tjetër gjest i bukur nga DRSHTRR e qytetit të Shkodrës është mbjellja e 250 fidanëve në Tarabosh, duke dhënë kështu një kontribut të vyer në pasurimin dhe ruajtjen e natyrës.



Ta pastrojmë Shqipërinë!

Patriotizëm nuk është vetëm ta duash vendin tënd, por edhe të respektosh e të mbash pastër ambientin ku jeton! Në prag të festave të nëntorit, DPSHTRR iu bashkua nismës "Ta Pastrojmë Shqipërinë" ku kolegët e DRSHTRR Fier dhe Sarandë u solidarizuan së bashku me nismën!



Festojmë së bashku!

Një tjetër akt mjaft humanitar u realizua nga stafi i DRSHTRR Elbasan. Në prag të festave, vizituan pavionin e pediatriisë në spitalin e Elbasanit, Qendrës Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta dhe strehës së qendrës "Tjetër Vizion", duke dhuruar dashuri e ngrohtësi për të gjithë fëmijët që ndodheshin aty.



16. ANËTARËSIME & ÇMIME

DPSHTRR, anëtare e CITA

DPSHTRR është anëtare e CITA (International Motor Vehicle Inspection Committee), rrjetit më të madh dhe një prej organizatave më të vjetra për verifikimin dhe historikun e mjetit, drejtuesit të mjetit, kontrollin e transportit rrugor, edukimin mbi sigurinë rrugore dhe mbrojtjen e ambientit, etj. CITA përfshin njëkohësisht edhe “Confederation of Organisations in Road Transport Enforcement” (CORTE) themeluar nga “EU Enforcers Group” partner i KE, me 70 anëtarë. CORTE ka finalizuar shumë nisma në fushën e transportit rrugor, ku përmendet edhe hartimi i kuadrit ligjor rregullator për tahografin digjital. Pas hartimit të saj, ka ofruar mbështetjen për implementimin në vendet e BE-së.

CITA ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me International Commission for Driver Testing (CIECA). CIECA është themeluar në vitin 1996 dhe aktualisht ka 71 ente anëtare nga 39 shtete të botës. Qëllimi i CIECA është të përmirësojë standardet për kualifikimet teorike e praktike të marrjes së lejes së drejtimit dhe të përmirësojë dhe rrisë edukatën rrugore.

Një hap historik për DPSHTRR-në, natyrisht edhe rezultat i transformimit dhe i modernizimit të nisur në vitin 2019, që mundëson horizonte të reja aksesit dhe informacioni me impakt direkt për shërbime edhe më cilësore për mjetin, drejtuesin e mjetit, transportin rrugor dhe sigurinë rrugore!

24

Aug

A new CITA member from Albania



The General Directorate of Road Transport Services (GDRTS) is an executive agency of the Albanian Ministry of Infrastructure and Energy, managing road transport services. The GDRTS was established by the Albanian Council of Ministers (Decision no. 343, date 21/07/1999) and has its Headquarter in Tirana. GDRTS represents a very dynamic enterprise status, operating as a state monopoly entity, regulated and based on the Albanian Road Code and in other legislative acts related to Road Transport.

The organisation employs a total of 800 staff.

GDRTS also includes the Directorate of License Plates and Printing which exclusively provides the supplying and the production process for the stamping of number plates and the supplying/printing

/issuance of all other vehicle/driver documents including the personalised Albanian driver license, operating also the distribution of all materials within the local directorates. Thanks to the latest investments and modern equipment, they are able to issue license plates and driving licenses comprising all safety elements in compliance with the European directives and standards, through advanced digital systems, within the Albanian governmental database, integrated in high security networks. They serve annually 2.5 million practices/services.

DPSHTRR, fituese e “Shërbimi Publik më i mirë” nga ICTS Awards

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor fiton çmimin “Shërbimi Publik më i mirë i vitit” në Edicionin e 8-të të Albanian ICT Awards, gara mbarëshqiptare në nderim të inovacioneve, shërbimeve risi dhe arritjeve teknologjike. Një vlerësim i çmuar për DPSHTRR-në për ofrimin e shërbimeve për transportin dhe automatizimin falë upgrade 100% të sistemeve operative, pajisjeve, teknologjisë moderne dhe digjitalizimit në ofrimin e lehtësive që impaktojnë qytetarët dhe subjektet, duke ofruar rreth 2,5 milionë shërbime online e në sportele, pa rritur tarifa e duke modernizuar infrastrukturën fizike dhe virtuale drejt një shërbimi transparent e cilësor.



DPSHTRR, anëtare e EWFA (European Window Film Association)

Rreth EWFA


EWFA, Shoqata Evropiane e Filmave Errësues të Xhamave përfaqëson dhe kërkon të çojë përpara interesat e industrisë së filmave të xhamave.

EWFA bashkon prodhuesit dhe shpërndarësit me qëllim promovimin e produkteve të filmave errësues të xhamave në kontinentin Evropian dhe nxjerrjen në pah të performancës së tyre inovative në tregjet e automjeteve dhe arkitekturës. Autoritetet kombëtare ndërmarrin hapa më të sigurt dhe më efikase për automjetet e shtetasve shqiptarë!

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, së fundmi ka nxjerrë një rregullore unike që lejon errësimin e xhamave për sektorin e automobilave që do të përdoren për qarkullim në territorin kombëtar.



Pas një vlerësimi të thelluar, DPSHTRR vendosi të implementojë rekomandimet e rregullores UN/ECE 43 dhe të lejojë përdorimin e errësuesve të xhamave në mënyrë që të rritet cilësia, standardet e sigurisë dhe sigurisë për sektorin e automjeteve dhe xhamat në përdorim. Ky hap siguron gjithashtu që Republika e Shqipërisë është në përputhje me standardet e përbashkëta, të zbatuara tashmë në shumë vende të Bashkimit Evropian.



13 Drejtori
Rajonale

17 Nënzyra
Shërbimesh

**në të gjithë
Shqipërinë!**

